


**Klasa e IV dhe V KENGUR 2015**

Koha në disponim është 1h e 15 min.



Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 24 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 120. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët.

**Cdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 8 vlerësohet me 3 pikë**



- (A) 6      (B) 7      (C) 8      (D) 10      (E) 15


2. Miri ka 10 shufra metalike të njëjta. Ai i ngjiti dy e nga dy shufrat dhe formoi pesë shufra më të gjata. Cila prej shufrave është më e gjata ?





- (A) A      (B) B      (C) C      (D) D      (E) E

3. Cili numër gjendet në vend të katrorit ?

- (A) 2      (B) 3      (C) 4      (D) 5      (E) 6





4. I bashkojmë pikat e dhëna në rreth sipas rregullit të mëposhtëm: fillojmë me pikën e shënuar me 1, e bashkojmë çdo pikë të dytë nga rrethi, derisa përsëri të vijë tek pika e shënuar me 1. Në figurë pika e shënuar me 1 është bashkuar në dy hapat e para. Cila figurë do të formohet me këtë bashkim ?



## Garë ndërkombëtare Kengur viti 2015

5. Në figurën djathtas është paraqitur kuleta e Teutës, së bashku me paratë që i kishte ajo. Teuta hyri në dyqan dhe bleu top për të cilin pagoi 7 denarë. Sa para i mbetën Teutës kur doli nga dyqani?




6. Prodhimi i shifrave të një numri dyshifror është 15. Sa është shuma e shifrave të këtij numri ?


(A) 2                      (B) 4                      (C) 6                      (D) 7                      (E) 8

7. Në figurë është paraqitur ishull i cili ka një breg me formë interesante dhe në të ka zhaba. Sa prej zhabave që janë vizatuar në figurë gjenden brenda në ishull?

(A) 5                      (B) 6                      (C) 7  
(D) 8                      (E) 9



8. Në pjesën e sipërme të çadrës sime është shkruar fjala KANGAROO (shiko figurën djathtas). Në cilën prej figurave të mëposhtme ndodhet çadra ime?



**Cdo detyrë me numër rendor nga 9 deri 17 vlerësohet me 4 pikë**

9. Miri e preu të gjithë figurën e paraqitur në vizatimin 1 në trekëndësja të njëjtë si në figurën 2. Sa trekëndësja fitoi Miri?

(A) 8                      (B) 12                      (C) 14  
(D) 15                      (E) 16



Цртеж 1




Цртеж 2

10. Miri ka 7 mollë dhe 2 banane. Ai i dha 2 mollë Lulit, ndërsa nga Luli mori banane. Në këtë mënyrë Miri tani ka aq mollë sa ka edhe banane. Sa banane Miri fitoi nga Luli?

(A) 2                      (B) 3                      (C) 4                      (D) 5                      (E) 7

11. Miri ndërtoi një kub të madh duke përdorur 27 kube të vegjël gri dhe të bardhë (si në figurë). Gjithashtu kubet që kanë të njëjtën ngjyrë nuk takohen. Sa kube të bardha përdori Miri?


(A) 10                      (B) 12                      (C) 13                      (D) 14                      (E) 15



## Garë ndërkombëtare Kengur viti 2015

12. Në garën e skive garonin 10 sportista. Miri i fitoi 3 sportista më shumë se sa e fituan atë. Cilin vend e zuri Miri?  
 (A) 1                      (B) 3                      (C) 4                      (D) 6                      (E) 7
13. Teuta ka 4 lodra: veturë, kukull, top dhe anije . Ajo do që t'i radhisë lodrat në raft. Anija duhet të jetë pranë veturës, ndërsa kukulla duhet të jetë pranë veturës. Në sa mënyra Teuta mund t'i radhisë lodrat?  
 (A) 2                      (B) 4                      (C) 5                      (D) 6                      (E) 8

14. Miri bën xhiro me biçikletë në park që ka formë si në figurë. Ai nisët nga pika S në drejtim të shigjetës. Në kryqëzimin e parë Miri kthehet djathtas, pastaj në kryqëzimin tjetër kthehet majtas, pastaj në tjetrin djathtas, përsëri majtas, dhe kështu me këtë radhitje. Në cilin prej vendeve të shënuara nuk do të kalojë Miri?





- (A) A                      (B) B                      (C) C  
 (D) D                      (E) E

15. Në figurë janë dhënë pesë nuselale. Dy nuselale quhen shoqe në qoftë se numri i pikave që kanë saktësisht ndryshon me 1. Në ditën Kangaroo çdo nuselale i dërgoi SMS mesazh çdo njëres prej shoqeve të saj. Sa SMS mesazhe u dërguan?  
 (A) 2                      (B) 4                      (C) 6                      (D) 8                      (E) 9




16. Figura e paraqitur në vizatim është ndarë në tre pjesë të njëjta. Si mund t'a kenë pamjen këto pjesë?



### Cdo detyrë me numër rendor nga 17 deri 24 vlerësohet me 5 pikë

17. Teuta do që të formojë kub nga një copë letër. Gabimisht ajo vizatoi dhe preu 7 katrorë në vend që të priste 6 (shiko figurën). Cili katror duhet prerë në mënyrë të tillë që nga katrorët e mbetur Teuta të mund të formojë kub?  
 (A) 1                      (B) 2                      (C) 3                      (D) 6                      (E) 7




18. Janë dhënë tre fletë transparente dhe disa kuti nga këto janë ngjyrosur me bojë të zezë (shiko figurën). Të tre fletët mund të rrotullohen pa u përmbysur. Më pas i vendosim saktësisht njëri mbi tjetrin. Cili është numri më i madh i mundshëm i katrorëve të zinj kur shikojmë katrorin e madh nga sipër?



- (A) 5                      (B) 6                      (C) 7                      (D) 8                      (E) 9


## Garë ndërkombëtare Kengur viti 2015

19. Numrat 2, 3, 5, 6 dhe 7 janë shënuar në katrorët e figurës djathtas, në mënyrë të tillë që shuma e numrave në rresht është e njëjtë me shumën e numrave në kolonë. Cili nga numrat e dhënë mund të jetë në qendër të figurës?



(A) vetëm 3      (B) vetëm 5      (C) vetëm 7      (D) 5 ose 7      (E) 3, 5 ose 7

20. Miri ka 10 topza të shënuar me numrat nga 0 deri në 9. Ai topzat i ndau me Lulin, Tanin dhe Teutën në këtë mënyrë:





Luli mori tre, Tani mori katër dhe Teuta mori tre topëza.

Më pas Miri i luti që t'i shumëzojnë numrat e shënuar në

topzat e tyre dhe të tregojnë rezultatin e fituar. Rezultatet e shumëzimit janë, Luli fitoi 0, Tani 72 dhe Teuta 90. Cila është shuma e numrave të shënuar në topzat të cilat i fitoi Luli?

(A) 11      (B) 12      (C) 13      (D) 14      (E) 15


21. Tre litarë janë vendosur në tokë si në figurën djathtas. Me ndihmën e tre litarëve të tjerë duhet të formohen tre unaza të lidhura si në zinxhir. Me cilët litarë të dhënë mund të realizohet kjo punë?




22. Në figurën djathtas është dhënë fletë me pika. Largësia midis pikave edhe në vijë horizontale edhe vertikale është e njëjtë.

Katër nga pikat janë kulmet e katrorit. Sa vlera të ndryshme mund të ketë suprina e katrorit të formuar në këtë mënyrë?

(A) 2      (B) 3      (C) 4      (D) 5      (E) 6



23. Miri vizatoi derkuc, peshkaqen dhe rinoceront dhe secilin nga vizatimet e preu në tre pjesë siç është treguar tek figurat. Më pas ai mund të formojë një kafshë të re me kombinim të një koke, një pjesë të mesit dhe një pjesë të pasme. Sa kafshë të ndryshme të vërteta dhe të çuditshme mund të formojë Miri?



(A) 3      (B) 9      (C) 15      (D) 27      (E) 30

24. Këtë vikend Teuta, Gea, Miri, Tani dhe Mira piqnin kulaçe. Gjatë vikendit Teuta poqi 24 kulaçe, Gea 25, Miri 26, Tani 27 dhe Mira 28. Gjatë vikendit njëri prej tyre poqi dy herë më shumë kulaçe sesa të shtunën, njëri prej tyre tre herë më shumë, njëri prej tyre katër herë më shumë, njëri prej tyre pesë herë më shumë dhe njëri prej tyre gjashtë herë më shumë kulaçe në vikend sesa të shtunën. Cili nga këta poqi më shumë kulaçe të shtunën?

(A) Teuta      (B) Gea      (C) Miri      (D) Tani      (E) Mira